

VENDIM
Nr. 267, datë 14.10.2022

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “ERNI SOLAR” SHPK, NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK, ME
KAPACITET TË INSTALUAR 2 mw**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 14, pikat 2 dhe 3, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimi ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 14.10.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1799/6 prot., datë 12.10.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Erni Solar’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 2 mw”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 227, datë 6.9.2022, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Erni Solar” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali gjenerues i energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet të instaluar 2 mw, për një afat 25-vjeçar.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 7.9.2022 dhe 8.9.2022) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 20.9.2022), nuk rezulton të ketë të tilla.

- Me shkresën nr. 1492/1 prot., datë 15.9.2022, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe dokumentacionin e konstatuar të munguar apo të plotësuar pjesërisht.

- Me qëllim sqarimin e të dhënave mbi sipërfaqen totale të zonës së projektit apo ndonjë gabimi të mundshëm në referencat përkatëse të kësaj prone që do të shfrytëzojë shoqëria “Erni Solar” sh.p.k. për ndërtimin dhe shfrytëzimin e projektit të centralit fotovoltaik, ERE planifikoi një seancë dëgjimore në datën 26.9.2022, me shoqërinë “Erni Solar” sh.p.k., shoqërinë “NTSP” sh.p.k., shoqërinë “RTS” sh.p.k., Bashkinë Devoll dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE). Njoftimi për këtë seancë u bë me shkresën nr. 1492/1 prot., datë 16.9.2022.

- Shoqëria “Erni Solar” sh.p.k., me e-mail-in e datës 21.9.2022, protokolluar në ERE me nr. 1492/3 prot., datë 21.9.2022, ka depozituar dokumentacion në kuadër të objektit të seancës, ndaj me qëllim shqyrtimin e këtij dokumentacioni, me shkresën e ERE-s nr. 1492/4 prot., u njoftuan palët e interesit për anulimin e seancës së planifikuar. Gjithashtu, shoqëria ka depozituar informacion dhe dokumentacion plotësues të aplikimit me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 1492/5 prot., datë 22.9.2022 dhe nr. 1492/6 prot., datë 23.9.2022.

- Nga shqyrtimi i sa depozituar nga shoqëria në lidhje me dokumentet pronësore që do të shfrytëzojë shoqëria “Erni Solar” sh.p.k. për ndërtimin dhe shfrytëzimin e projektit të centralit fotovoltaik, rezulton se ajo ka nënshkruar disa aktmarrëveshje të reja.

- Sa depozituar së fundi nga shoqëria “Erni Solar” sh.p.k. edhe pse rregullon pronësinë e saj, afekton dokumentet pronësore dhe sipërfaqen e territorit ku do të shtrihen projektet e ndërtimit dhe shfrytëzimit të centraleve fotovoltaike të shoqërive të tjera palë në këto aktmarrëveshje, të cilat janë gjithashtu të licencuara nga ERE, çka mund të kërkojë sipas rastit rishikim të këtyre vendimeve.

- Duke qenë se në kontratat përkatëse të nënshkruara me MIE-n referohen aktmarrëveshjet e mëparshme, për sa u përket dokumenteve pronësore të territorit ku do të zhvillohet projekti, e po ashtu duke qenë se me aktmarrëveshjet e reja sipërfaqja totale pronësore e disa prej subjekteve nënshkruese të aktmarrëveshjeve ndryshon nga ajo e referuar në kontratat me MIE-n, vlerësohet se duhet të vijojë komunikimi shkresor për të marrë konfirmimin e MIE-s mbi këto ndryshime, duke marrë në konsideratë dhe zhvillimin e një seance të mundshme dëgjimore me palët.

- Po ashtu, vlerësohet që në lidhje me nënshkrimin e këtyre aktmarrëveshjeve të reja duhet të merret dhe konfirmimi i Bashkisë Devoll.

- Në nenin 14, pika 3, e rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, është parashikuar se Bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë pune.

- Për të sqaruar gjithë sa parashtruar me palët e përfshira në lidhje me dokumentacionin pronësor vlerësohet shtyrja deri në 30 (tridhjetë) ditë pune e afatit të vendimmarrjes së Bordit mbi aplikimin e shoqërisë për t’u licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaike me kapacitet të instaluar 2 mw.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të shtyjë deri në 30 (tridhjetë) ditë pune afatin e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s mbi aplikimin e shoqërisë “Erni Solar” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaike me kapacitet të instaluar 2 mw.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin dhe palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti